

VENDIM
Nr. 415, datë 27.5.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË TURQISË, PËR NJOHJEN E NDËRSJELLË DHE
SHKËMBIMIN E LEJEVE TË DREJTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për njohjen e ndërsjellë dhe shkëmbimin e lejeve të drejtimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË PËR NJOHJEN E NDËRSJELLË DHE
SHKËMBIMIN E LEJEVE TË DREJTIMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
dhe
Qeveria e Republikës së Turqisë,

(më poshtë të quajtura “Palë Kontraktuese”),
me qëllim përmirësimin e sigurisë së transportit rrugor, si dhe lehtësimin e qarkullimit rrugor në territoret e Palëve Kontraktuese,
kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Palët Kontraktuese njohin reciprokisht shkëmbimin e lejeve të drejtimit të rregullta, të lëshuara nga autoritetet kompetente të Palës tjetër Kontraktuese, në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm në favor të mbajtësve të lejeve të drejtimit, të cilëve u është dhënë leja e qëndrimit ose e qëndrimit të përkohshëm në territorin e tyre.

Palët Kontraktuese njohin, gjithashtu, për qëllime qarkullimi në territoret e tyre, lejet kombëtare të drejtimit të lëshuara nga Pala tjetër Kontraktuese brenda periudhës së vlefshmërisë së tyre.

Neni 2

Leja e drejtimit e lëshuar nga një prej autoriteteve të Palëve Kontraktuese, pushon së qeni e vlefshme për përdorim në qarkullim në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, pas një viti nga data e dhënies së lejes së qëndrimit ose qëndrimit të përkohshëm mbajtësit të saj në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 3

Në interpretim të neneve të kësaj marrëveshjeje, termi “qëndrim dhe qëndrim i përkohshëm” ka kuptimin e përcaktuar dhe të rregulluar nga kuadri përkatës ligjor në fuqi i Palëve Kontraktuese.

Neni 4

Nëse një mbajtësi të lejeve të drejtimit, të lëshuara nga autoritetet e Palëve Kontraktuese, i është dhënë leja e qëndrimit ose qëndrimit të përkohshëm në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, ata konvertojnë reciprokisht lejet e tyre të drejtimit pa iu nënshtruar provimeve të detyrueshme teorike dhe praktike.

Autoritetet kompetente kërkojnë një certifikatë mjekësore, e cila vërteton se një person ka kaluar provimin e cilësive psikofizike, të kërkuara për kategorinë specifike.

Për zbatimin e paragrafit të parë të këtij neni, mbajtësit e lejes së drejtimit duhet të kenë moshën e parashikuar nga legjislacionet e brendshme përkatëse të Palëve Kontraktuese për lëshimin e kategorisë për të cilën kërkon shkëmbimin.

Neni 5

Në kohën e konvertimit të lejeve të drejtimit, kategoritë e barasvlershme të lejeve të drejtimit të Palëve Kontraktuese njihen në bazë të tabelave teknike të barasvlershmërisë, që i bashkëlidhen kësaj Marrëveshjeje, të cilat përbëjnë pjesë integrale të saj. Këto tabela, së bashku me një listë të modeleve të lejeve të drejtimit, përbëjnë shtojcat teknike që mund të ndryshohen me anë të një njoftimi me shkrim ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese.

Autoritetet qendrore kompetente të Palëve Kontraktuese, për shkëmbimin dhe verifikimin e lejeve të drejtimit janë:

a) në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;

b) në Republikën e Turqisë, Ministria e Brendshme, Policia Kombëtare Turke.

Palët Kontraktuese përdorin gjuhën angleze në zbatim të kësaj Marrëveshjeje dhe, gjithashtu, mund të bien dakord mbi përdorimin e gjuhëve të tjera për komunikim.

Neni 6

Gjatë procedurës së konvertimit të lejeve të drejtimit, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese tërheqin lejet që duhet të konvertohen dhe ua kthejnë autoriteteve kompetente të Palës tjetër Kontraktuese, bashkë me një listë të këtyre lejeve dhe një njoftim.

Neni 7

Autoriteti kompetent i secilës prej Palëve Kontraktuese, i cili vlerëson përmbushjen e kushteve për shkëmbimin e lejes së drejtimit, kërkon përkthimin zyrtar të lejes së drejtimit. Ky autoritet i kërkon informacion autoriteteve kompetente të Palës tjetër Kontraktuese, në lidhje me vlefshmërinë e lejes së drejtimit dhe të dhënave të treguara në të.

Shkëmbimi i informacionit për konvertim kryhet me *fax/e-mail*, duke përdorur modelin e “Kërkesës” dhe të “Certifikatës së vlefshmërisë të lejes së drejtimit”, bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje. Kërkesa dhe certifikata përbejnë shtojcën teknike, që mund të ndryshohet nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese me anë të një njoftimi me shkrim.

Të dhënat i dërgohen drejtpërdrejt autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese kërkuese.

Neni 8

Autoriteti qendror kompetent i një Pale Kontraktuese që merr lejen e drejtimit të tërhequr, pas konvertimit, njofton autoritetin qendror kompetent të Palës tjetër Kontraktuese nëse dokumenti përmban parregullsi në lidhje me vlefshmërinë dhe të dhënat e treguara në të.

Neni 9

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke konfirmuar që Palët Kontraktuese kanë plotësuar procedurat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të saj.

Kjo Marrëveshje do të përfundojë për një periudhë të pacaktuar kohore. Secila Palë Kontraktuese mund të denoncojë këtë Marrëveshje në çdo kohë me njoftim me shkrim për Palën tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në një rast të tillë, denoncimi do të hyjë në fuqi gjashtë muaj nga data e marrjes së njoftimit të tillë.

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve Kontraktuese. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitën e paragrafit 1, të këtij neni.

Bërë në Tiranë, më 12.2.2020, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, turke dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gent Cakaj

Ministër në detyrë për Evropën dhe Punët e
Jashtme

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
TURQISË


Mevlut Çavuşoğlu

Ministër i Punëve të Jashtme


MODELET E LEJEVE TË DREJTIMIT

I. Modeli i lejes së drejtimit Shqiptare i lëshuar nga 01.07.2005 deri më 23.01.2017, (modeli i vjetër).

Ana ballore




Ana e pasme




II. Modeli i lejes së drejtimit shqiptare i lëshuar nga 24.01.2017, (modeli i ri).

Ana ballore




Ana e pasme




Modelet e lejeve të drejtimit të lëshuara në Republikën e Turqisë

Ana ballore



Ana ballore



Ana Ballore




Ana ballore



1

Ana e pasme



Ana pasme



Ana pasme



4

Ana pasme

[illegible]

Leje drejtimi shqiptare	Leje drejtimi turke								
	A1	A2	B	C	D	E	F	G	H
A	✓	✓							
B			✓						
C				✓			✓		
D						✓			
BE							✓		
CE					✓				
DE					✓	✓			

[illegible]

II. Për shkëmbimin e lejeve të drejtimit shqiptare, (modeli i ri), të lëshuara në Republikën e Shqipërisë pas datës 24.01.2017, me leje drejtimi turke.

Leje drejtimi shqiptare	Leje drejtimi turke														
	AM	A1	A2	A	B1	B	C1	C	D1	D	BE	C1E	CE	D1E	DE
AM	✓														
A1		✓													
A2			✓												
A				✓											
B1					✓										
B						✓									
C1							✓								
C								✓							
D1									✓						
D										✓					
BE											✓				
C1E												✓			
CE													✓		
D1E														✓	
DE															✓

III. Për shkëmbimin e lejeve të drejtimit turke (modeli i vjetër) të lëshuara në Republikën e Turqisë para datës 01.01.2016, me leje drejtimi shqiptare.

Leje drejtimi turke	Leje drejtimi shqiptare						
	A	B	C	D	BE	CE	DE
A1							
A2	✓						
B		✓					
C			✓				
D					✓	✓	
E (para 27.4.1997)				✓	✓	✓	✓
E (pas 27.4.1997)				✓			
F							
G							
H							

IV. Për shkëmbimin e lejeve të drejtimit (modeli i ri), të lëshuara në Republikën e Turqisë pas datës 01.01.2016, me leje drejtimi shqiptare.

[illegible]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Drejtoria e Përgjithshme e
Shërbimeve të Transportit Rrugor
Fax: 00355 4 2238175
E-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al

REPUBLIKA E TURQISË
Ministria e Brendshme
Drejtoria e Përgjithshme e
Regjistrimit Civil dhe Shtetësisë
Fax: 0.312.397 26 92
E-mail: sb.arnavutluk@nvi.gov.tr

KËRKESE

**PËR KONFIRMIMIN E VLEFSHMËRISË SË LEJES SË DREJTIMIT
NR. _____**

Lutemi na informoni nëse leja e drejtimit nr. _____ është e rregullt dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

A. Të dhëna të mbajtësit të lejes së drejtimit

- Emri: _____
- Mbiemri: _____
- Datëlindja: _____
- Vendlindja: _____
- Data e lëshimit: _____
- Data e skadimit: _____
- Numri i lejes: _____
- Kategoritë: _____
- Adresa: _____

Bashkëlidhur fotokopja e lejes së drejtimit.

DATA DHE VENDI

VULA DHE FIRMA E NËPUNËSIT

REPUBLIKA E TURQISË
Ministria e Brendshme
Drejtoria e Përgjithshme e
Regjistrimit Civil dhe Shtetësisë
Fax: 0.312.397 26 92
E-mail: sb.arnavutluk@nvi.gov.tr

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Drejtoria e Përgjithshme e
Shërbimeve të Transportit Rrugor
Fax: 00355 4 2238175
E-mail: dpshtrr@dpshtrr.gov.al

KËRKESE

**PËR KONFIRMIMIN E VLEFSHMËRISË SË LEJES SË DREJTIMIT
NR. _____**

Lutemi na informoni nëse leja e drejtimit nr. _____ është e rregullt dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

A. Të dhëna të mbajtësit të lejes së drejtimit

- Emri: _____
- Mbiemri: _____
- Datëlindja: _____
- Vendlindja: _____
- Data e lëshimit: _____
- Data e skadimit: _____
- Numri i lejes: _____
- Kategoritë: _____
- Adresa: _____

Bashkëlidhur fotokopja e lejes së drejtimit

DATA DHE VENDI

VULA DHE FIRMA E NËPUNËSIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Drejtoria e Përgjithshme e
Shërbimeve të Transportit Rrugor
Fax: 00355 4 2238175
E-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al

REPUBLIKA E TURQISË
Ministria e Brendshme
Drejtoria e Përgjithshme e
Regjistrimit Civil dhe Shtetësisë
Fax: 0.312.397 26 92
E-mail: sb.arnavutluk@nvi.gov.tr

CERTIFIKATË VLEFSHMËRIE E LEJES SË DREJTIMIT

Nr. _____

Letemi informohuni se leja e drejtimit me numër _____ është e rregullt dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

A. Të dhëna të mbajtësit të lejes së drejtimit

- Emri: _____
- Mbiemri: _____
- Datëlindja: _____
- Vendlindja: _____
- Data e lëshimit: _____
- Data e skadimit: _____
- Numri i lejes: _____
- Kategoritë: _____
- Adresa: _____

B. Kërkesa të tjera të mundshme: (për shembull syze të detyrueshme, protezë akustike etj.):

C. Leja e drejtimit është lëshuar/ nuk është lëshuar nga konvertimi i një leje tjetër të huaj të lëshuar nga: _____

DATA DHE VENDI

VULA DHE FIRMA E NËPUNËSIT

REPUBLIKA E TURQISË
Ministria e Brendshme
Drejtoria e Përgjithshme e
Regjistrimit Civil dhe Shtetësisë
Fax: 0.312.397 26 92
E-mail: sb.arnavutluk@nvi.gov.tr

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Drejtoria e Përgjithshme e
Shërbimeve të Transportit Rrugor
Fax: 00355 4 2238175
E-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al

CERTIFIKATË VLEFSHMËRIE E LEJES SË DREJTIMIT

Nr. _____

Lutemi informohuni se leja e drejtimit me numër _____ është e rregullt dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

A. Të dhëna të mbajtësit të lejes së drejtimit

- Emri: _____
- Mbiemri: _____
- Datëlindja: _____
- Vendlindja: _____
- Data e lëshimit: _____
- Data e skadimit: _____
- Numri i lejes: _____
- Kategoritë: _____
- Adresa: _____

B. Kërkesa të tjera të mundshme: (për shembull syze të detyrueshme, protezë akustike etj.):

C. Leja e drejtimit është lëshuar/ nuk është lëshuar nga konvertimi i një leje tjetër të huaj të lëshuar nga:

DATA DHE VENDI

VULA DHE FIRMA E NËPUNËSIT